

MAPL
Departamenti Ligjor dhe
Monitorim të Komunave

Divizioni për Monitorim të
Komunave

Raport i Funksionimit të Kuvendeve
të Komunave të Republikës së
Kosovës
Janar- Qershor 2013

Prishtinë, 2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

**RAPORT I FUNKSIONIMIT TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Janar-Qershor 2013

Korrik, Prishtinë 2013

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Qëllimi i Raportit.....	5
Përmbledhje ekzekutive.....	5
I. FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE.....	6
2. Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendeve të Komunave	6
3. Njoftimi për mbledhjet e kuvendit, procedurat dhe afatet.....	8
4. Rëndësia e hartimit të rendit të ditës dhe koordinimi në mes të organeve të komunës.....	9
5. Arsyet e bojkotimit dhe lëshimit të mbledhjeve të kuvendit të komunës	10
6. Raportimi i ekzekutivit në Kuvendin e Komunës	12
7. Komitetet e Kuvendit të Komunës	13
8. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.....	16
9. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	18
10. Takimet publike me qytetarë.....	20
11. Ueb-faqet zyrtare të komunave.....	21
II. AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE	23
1. Rregulloret dhe vendimet e miratuara në Kuvendet e Komunave.....	23
2. Llojet e akteve të miratuara.....	25
3. Aktet e miratuara të karakterit financiar	27
III. MBIKËQYRJA E KOMUNAVE NGA AUTORITETET QENDRORE	28
1. Dërgimi i akteve për shqyrtim të ligjshmërisë	28
2. Shkeljet Ligjore të Evidentuara	29
3. Kërkesat e organit mbikëqyrës për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme nga komunat	30
4. Llojet e shkeljeve ligjore.....	31
5. Rastet e shkeljeve ligjore në komuna të konstatuara nga MAPL dhe veprimet e komunave ndaj shkresave për rishqyrtim të akteve	32
6. Komunat të cilat nuk kanë rishqyrtuar vendimet e kundërligjshme me kërkesat e organit mbikëqyrës për respektim të ligjshmërisë	34
7. Rastet e shkeljeve procedurale.....	37
Konkluzione.....	
Rekomandimet.....	

Hyrje

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komunitatet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Vetëqeverisja lokale në Kosovë promovon sjelljen demokratike, transparencën dhe llogaridhënien si dhe garanton një sistem kontrolli të ndërsjellë në nivel komunal për të siguruar respektimin e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë.

Komunitatet janë të obliguara që ushtrimin e kompetencave të bëjnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore. Po ashtu, komunitatet organizojnë administratën sipas strukturës së nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, krijojnë të hyrat financiare dhe i administrojnë ato sipas nevojave të tyre konform legjislacionit përkatës për menaxhimin e financave publike.

Pavarësisht individualitetit të komunave në kryerjen e veprimtarive të tyre, legjislacioni ka përcaktuar një shkallë të varësisë në marrëdhënie me organet qendrore. Në kuadër të kësaj, parashikimi me ligj i funksionit me natyrë mbikëqyrëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrive të tjera të linjës ndaj komunave, është me rëndësi të veçantë, pasi që mundëson monitorim të vazhdueshëm të ushtrimit të kompetencave në nivel lokal. Kjo përkon me mbikëqyrjen e respektimit të ligjshmërisë, të parashikuar me ligj dhe të vendosur vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave, përmes Divizionit të Monitorimit të Komunave, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës. Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i komunave dhe ofrimi i informatave tek mekanizmat përgjegjës për evitimin e veprimeve komunale të cilat bien ndesh me dispozitat juridike të legjislacionit në fuqi.

Prezantimi i aktiviteteve të Kuvendeve të Komunave është mekanizëm i rëndësishëm i vënies së përgjegjësisë së komunave para qytetarëve dhe institucioneve publike. Ky raport përmbledh dhe shtjellon çështjet më të rëndësishme të cilat janë në mandatin e organeve komunale, përkatësisht kuvendit të komunës dhe ekzekutivit. Fokusi kryesor është vënë në pasqyrimin e punës së kuvendeve të komunave, duke ditur se në mënyrë indirekte përfshinë edhe shpалosjen e punës së ekzekutivit, për faktin se ky i fundit i raporton Kuvendit në baza të rregullta periodike ose atëherë kur kërkohet.

Qëllimi i Raportit

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve, komunave dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të komunave karshi sistemit juridik të vendit. Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal.

Në këtë dokument janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punimeve të kuvendeve të komunave. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Dokumenti është ndarë në tre kapituj, që përfshinë të dhënat për të gjitha komunat.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 34 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë për Komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk kemi të dhëna.

Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve të cilat nuk janë në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale.

I. FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

1. Vështrime hyrëse

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i pushtetit lokal dhe njëkohësisht organi mbikëqyrës i autorizuar ligjërisht për sigurimin e ofrimit të shërbimeve nga ana e ekzekutivit të komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të ushtruar funksionin e vet, Kuvendi i Komunës duhet mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushëveprimtarisë së tij, për të miratuar aktet normative të nevojshme për komunën, të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi, ato të cilat ligjet i lënë të hapura për tu nxjerrë në nivelin lokal varësisht nga nevojat e komunave, si dhe për të diskutuar dhe vendosur çështjet me interes të komunës. Ky kapitull ofron përgjigje për një numër çështjesh të nivelit lokal të qeverisjes, duke paraqitur rrjedhën e aktiviteteve të kuvendeve të komunave, përkatësisht mbledhjet e mbajtura, funksionimin e tyre, respektimin e afateve ligjore për thirrjen e mbledhjeve, transparencën, funksionimin e trupave të kuvendeve të komunave, bashkëpunimin dhe mënyrën e ushtrimit të kontrollit ndaj ekzekutivit, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

2. Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendeve të Komunave

Korniza ligjore për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës ka përcaktuar disa kriterë në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të organeve komunale. Në lidhje me këtë, LVL ka vënë disa rregulla, që i referohen mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të ketë njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmuorin e parë të vitit¹. Ky është kufiri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

Gjatë kësaj periudhe të gjitha komunat të përfshira në raport kanë respektuar kriterin prej së paku 5 mbledhjeve të përcaktuar për kuvendet e komunave. Disa komuna janë treguar më aktive jo vetëm për nga numri i takimeve të mbajtura, por edhe për nga materia e vendosur, mënyra e zhvillimit të takimeve, njoftimit me kohë, konsultimeve

¹ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

mes subjekteve politike të përfaqësuar në kuvend, diskursit të mbajtur, koordinimit me komitete, mënyrës së votimit dhe respektimit të afateve ligjore dhe standardeve të përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm.

Në këtë periudhë janë mbajtur 197 mbledhje të rregullta dhe 33 të jashtëzakonshme të kuvendeve të komunave. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme në kuvendet e komunave:




Fig.1. Të dhënat e mbledhjeve të kuvendeve të komunave për periudhën janar-qershor 2013.

Edhe pse LVL nuk ka saktësuar kur mund të mbahen mbledhjet e jashtëzakonshme, gjatë kësaj periudhe në komuna janë thirr 33 mbledhje të jashtëzakonshme. Kryesisht, mbledhjet e jashtëzakonshme janë thirr me qëllim të rishikimit buxhetor të komunave, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave të dërguar me datën 5 qershor 2013 dhe afatit të përcaktuar për dorëzim të rishikimit buxhetor nga komunat deri më datën 12 qershor 2013, por këto mbledhje janë mbajtur edhe për qëllime të tjera.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme të theksohet është forma e mbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve. Në të gjitha rastet, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, por interesimi i qytetarëve nuk duket të jetë në nivelin e kënaqshëm. Në anën tjetër, edhe pse dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale u mundësojnë komunave që në raste të caktuara, për arsye specifike, të përjashtojnë opinionin nga mbledhjet e kuvendit, deri tani nuk është marrë ndonjë vendim nga ana e Kuvendeve të Komunave për përjashtim të publikut pavarësisht natyrës së çështjeve të trajtuara.

Për dallim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, në vitin 2013 komunat kanë shtuar numrin e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

**Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave në periudhën
janar-qershor 2012 dhe janar - qershor 2013**




Fig.2. Të dhënat e mbledhjeve të kuvendeve të komunave për periudhën janar-qershor 2013

Sipas të dhënave, në periudhën janar-qershor të vitit 2012, Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë realizuar gjithsej 163 mbledhje të rregullta dhe 10 të jashtëzakonshme, e që nënkupton faktin se këtë vit janë realizuar 57 mbledhje më tepër, prej të cilave 34 të rregullta dhe 23 të jashtëzakonshme.

3. Njoftimi për mbledhjet e kuvendit, procedurat dhe afatet

Komunat janë të obliguara të bëjnë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve. Këtu përfshihen disa elemente të domosdoshme, siç është: përgatitja e njoftimit me kohë, në të cilin përshkruhet data e mbledhjes, koha e mbledhjes, vendi, rendi i ditës dhe materialet e mbledhjeve². Kuvendet e komunave i kanë miratuar Planet e Punës, me të cilat kanë rregulluar ndër të tjera oraret e takimeve të kuvendeve. Në vazhdimësi është theksuar që komunat t'i kushtojnë rëndësi këtyre elementeve, pasi në disa raste zyrtarët e monitorimit janë anashkaluar nga e drejta për t'u informuar me kohë lidhur me mbajtjen e mbledhjeve, ndërsa edhe më tepër janë anashkaluar nga e drejta për t'u njoftuar me materialet e mbledhjeve të parapara për rendin e ditës. Ka pasur raste kur komunat nuk kanë respektuar afatet ligjore për dërgimin e ftesës së mbledhjeve ose kur ftesën nuk e kanë dërguar fare. Ky problem është vërejtur sidomos me rastin e thirrjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme. Sipas LVL-së, anëtarët e kuvendit, por edhe organi mbikëqyrës, duhet të njoftohen me shkrim së paku tri (3) ditë

² Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.3.

pune para datës së mbajtjes së takimit³. Megjithatë kjo normë nuk u respektua në këto komuna: Ferizaj, Prizren, Shtime, Kaçanik, Istog, Deçan, Hani i Elezit, Peja, Kamenica, Dragashi, Klina, Podujevës dhe Fushë Kosovë, pasi që njoftimin e kanë bërë me vonesë. Si pasojë e kësaj vonese, ishte dështimi i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Istogut.

Megjithëse ka përmirësime ndër vite në këtë aspekt, ende për disa komuna mbetet problem çështja e dërgimit paraprak të materialeve të rendit të ditës së mbledhjeve të kuvendit. Disa komuna, paraprakisht nuk i kanë bërë të njohura projektvendimet, projekt-rregulloret, planet e ndryshme ose shënimet e nevojshme për çështjet e caktuara, ose këto dokumente i kanë dërguar vetëm pjesërisht. Në këtë grup të komunave mund të përmendim: Junikun, Rahovecin, Deçanin, Mamusha, Dragashin. Për dallim nga to, në Komunat: Graçanicë, Ranillug, Kllokot dhe Partesh, dërgimi i materialeve të mbledhjeve si rregull është bërë në gjuhën serbe, ndërsa në gjuhën shqipe është bërë me vonesë për shkak të numrit të kufizuar të zyrtarëve për përkthim.

Nga kjo vërejmë që komunat e lartpërmendura kanë pasur ngecje në këtë drejtim duke anashkaluar nenin 43 të LVL-së dhe mos i kushtuar rëndësinë e duhur çështjeve paraprake. Komunat duhet t'i kenë parasysh përgjegjësitë ligjore dhe të ndërmarrin veprimet e tyre brenda kufijve të lejuar ligjor. Për procesin e mbikëqyrjes ky element konsiderohet i rëndësishëm, pasi mundëson identifikimin paraprak të problemeve, për të cilat organi mbikëqyrës mund të ofroj konsultime për organet e vetëqeverisjes lokale dhe të parandaloj nxjerrjen e akteve të kundërligjshme.

Sipas nenit 43 të LVL-së, komunat obligohen 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të dërgojnë njoftimin në të cilin në mes tjerash bashkëngjiten materialet e mbledhjes së kuvendit.

4. Rëndësia e hartimit të rendit të ditës dhe koordinimi në mes të organeve të komunës

Një çështje tjetër është edhe përpilimi i pikave të rendit të ditës. “Rendi i ditës për takimin e kuvendit të komunës caktohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës”⁴. Si rregull, aktivitetet e Kuvendit të Komunës përcaktohen në Planin e Punës së Kuvendit, në të cilën përfshihen të gjitha obligimet ligjore të komunave për të nxjerrë akte nënligjore për funksionimin e tyre, përcaktohet

³ Po aty, neni 44.4

⁴ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 47.1

agjenda e punës për tërë vitin rreth miratimit të Rregulloreve, Planeve, Strategjive, çështjeve të tjera të natyrës financiare dhe akteve të tjera . Në të vërtetë, propozimet e paraqitura për miratim në të shumtën e rasteve rrjedhin nga ekzekutivi i komunës. Andaj edhe ligji kërkon bashkëpunimin në mes të dy blloqeve, ekzekutivit dhe Kuvendit e gjithashtu me komitetet e obligueshme, komitetet e tjera dhe aty ku janë themeluar komitetet konsultative. Në rastet kur ky koordinim ka munguar, ka ardhur në shprehje deri tek shprehja e pengesave të caktuara përmes mospjesëmarrjes së kuvendarëve në mbledhjet e kuvendit, mos-votimit të një pike të caktuar apo edhe lëshimit të mbledhjes në shenjë pakënaqësie.

Një dispozitë e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka lejuar që “anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohej të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike”⁵. Ka pasur raste kur anëtarët kanë kërkuar përfshirjen e pikave të caktuara në rendin e ditës të cilat i janë nënshtruar procesit të votimit. Mirëpo, kjo normë e LVL-së në disa raste edhe është tejkaluar, pasi është bërë praktikë në disa komuna të inkorporohen pika shtesë të cilësuarat të natyrës urgjente dhe se zakonisht këto pika janë propozuar nga kryetarët e komunave. Gjithashtu, ka pasur raste kur në fund të mbledhjes së kuvendit është propozuar pikë shtesë në rendin e ditës, duke shkelur kështu Ligjin për vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës. Rastet për të cilat ka pasur pakënaqësi rreth rendit të ditës propozimeve të caktuara, të cilat për pasojë kanë pasur lëshimin e mbledhjeve, janë evidentuar në komunat: Gjilan (1 rast), Prizren (1 rast), Istog (1 rast) Podujevë 1 rast, Shtime (1 rast), Ferizaj (1 rast).

Ligji për vetëqeverisje lokale nuk e ka përcaktuar të drejtën e kryetarit të komunës për propozimin e pikave shtesë të rendit të ditës gjatë mbajtjes së mbledhjes, e as para fillimit të saj.

5. Arsyet e bojkotimit dhe lëshimit të mbledhjeve të kuvendit të komunës

Siç u theksua më lartë, në këtë periudhë janë shprehur një numër i rasteve kur anëtarësia e kuvendeve të Komunave kanë lëshuar mbledhjen në shenjë pakënaqësie rreth problemeve të caktuara. U përmendën po ashtu rastet të shprehura në numër në disa komuna, ndërsa në vijim kemi paraqitur figurën me të cilën jepen edhe arsyet e lëshimit të mbledhjeve:

⁵ Po aty, 47.2

Arsyet e mosmbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave dhe lëshimit të mbledhjeve nga subjektet politike të përfaqësuara




Fig.3. Të dhënat për arsyet e mosmbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe lëshimit të tyre

Këto raste janë paraqitur në komunat: Gjilan, Istog, Prizren, Podujevë, Malishevë dhe Shtime. Në *komunën e Gjilanit*, mbledhja e kuvendit është braktisur nga njëri subjekt politik i përfaqësuar, për shkak të mospajtimit për të diskutuar dhe përfshirë në rendin e punës Propozim-vendimin për kompensimin e dëmeve pronarëve gjatë implementimit të projektit në lumin “Mirusha”. Ky propozim është bërë në fund të mbledhjes nga kryesuesi i kuvendit që paraqet shkelje të nenit 30.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës. Megjithatë, lëshimi i mbledhjes njëra pjesë e anëtarëve të kuvendit nuk ka ndikuar në kuorum dhe mbledhja është zhvilluar.

Në *Komunën e Istogut*, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, dy subjekte politike të përfaqësuara në Kuvend kanë lëshuar mbledhjen për shkak të dërgimit të ftesës për mbledhje me vonesë. Mbledhja e kuvendit të kësaj komune është shtyer për një datë tjetër.

Në *Kuvendin e Komunës së Malishevës* mbledhja e planifikuar në muajin maj ka dështuar dy herë për shkak të mungesës së kuorumit.

Në *Kuvendin e Komunës së Podujevës* në mbledhjen e muajit mars është bojkotuar mbledhja nga opozita me arsyetimin se nuk është përfillë kërkesa e tyre për të shtyrë për mbledhjen e radhës shqyrtimin e Raportit financiar për vitin 2012 si dhe propozim-vendimit për përcaktimin në interes publik të një pjese të tokave të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës së Podujevës. Ky bojkot nuk ka pasur për pasojë zhvillimin e mbledhjes pasi që nuk ka ndikuar në kuorum.

Një rast të lëshimit të seancës ka pasur edhe në *Kuvendin e Shtimes* në mbledhjen e mbajtur më datën 5.04.2013, pasi disa nga anëtarët e kuvendit kanë lëshuar mbledhjen me arsyetimin se nuk kanë kaluar propozimet e tyre për rendin e ditës.

Në *Kuvendin e Komunës së Prizrenit* ka pasur një rast të lëshimit të mbledhjes për shkak të mos përfshirjes në rendin e ditës të "Kërkesës për interpelancë e Drejtorit të Arsimit". Mbledhja është shtyrë si rezultat i mungesës së kuorumit pas lëshimit të saj.

Poashtu Në *Kuvendin e Komunës së Prizrenit* mbledhja e jashtëzakonshme e planifikuar në muajin mars për shqyrtimin e gjendjes së arsimit fillor e të mesëm në Komunën e Prizrenit dhe debatit në mes të kuvendit dhe kryetarit të komunës ka dështuar për shkak të mospjesëmarrjes së shumicës së anëtarëve të kuvendit dhe mungesës së kuorumit për mbajtje të mbledhjes.

Në *Kuvendin e Komunës së Kamenicës* është lëshuar mbledhja nga radhët e opozitës për shkak të mosdhënies së fjalës anëtarit të kuvendit dhe ndërhyrjes së kryetarit të komunës në punën e kuvendit. Megjithatë mbledhja është zhvilluar dhe lëshimi i mbledhjes nga subjekti opozitar nuk ka pasur ndikim në kuorum.

6. Pjesëmarrja dhe raportimi i kryetarit të komunës në Kuvendin e Komunës

Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e kryetarit të komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Mirëpo, ky ligj nuk ka qartësuar nëse raportet e prezantuar do t'i nënshtrohen një procesi të votimit, si dhe pasojat e mosaprovimit të tyre. Në praktikë është parë se kryetarët e komunave paraqesin me shkrim raportet në kuvendet e komunave, miratimi i të cilave është çështje e brendshme e komunave dhe pa pasoja juridike. Forma të tjera të raportimit janë ato verbale, ku anëtarësia e kuvendit parashtrohet pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje. Disa kuvende të komunave i japin prioritet parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta ekzekutivit të komunës (Rahoveci, Gjakova, Deçani, Mitrovica, Prishtina, Fushë-Kosova, Ferizaji, Kaçaniku, Vushtri, etj), duke rregulluar këtë segment me prioritet në rendin e ditës. Për të realizuar me sukses këtë formë të kontrollit, nevojitet prezenca e kryetarëve të komunave, nënkryetarëve të komunave dhe drejtorëve të drejtorive të komunave në mbledhjet e kuvendit. Është vërejtur se kryetarët e komunave jo gjithëherë i kushtojnë rëndësi prezencës së tyre në mbledhjet e kuvendit të komunës, pasi këtë obligim, në të shumtën e rasteve e bartin te nënkryetarët e komunave dhe drejtorët e drejtorive. Gjatë kësaj periudhe, prezenca e

kryetarëve të komunave nuk është vërejtur në këto komuna: Malishevë, Skenderaj dhe Rahovec. Krahas tyre, në Komunat, Deçan, Gjiilan, Ferizaj dhe Mamushë, kryetarët e komunave jo çdoherë kanë qenë prezent në mbledhjet e Kuvendit, ndërkaq në komunat e tjera pjesëmarrja e tyre ka qenë prezente.

Lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të paraqitur raportin tremujor buxhetor, kjo është bërë në të gjitha komunat. Edhe pse Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive nuk e ka kërkuar votimin (miratimin) e raporteve financiare nga Kuvendet e Komunave, miratimi i këtyre raporteve është praktikë e shumicës së komunave. Ndërsa, komunat të cilat nuk e praktikojnë votimin e raporteve financiare të ekzekutivit janë: Kaçaniku, Parteshi, Deçani, Graçanica, Gjakova, Mitrovica, Rahoveci dhe Suhareka.

7. Komitetet e Kuvendit të Komunës

Me sistemin e tanishëm të vetëqeverisjes lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme për të mbështetur punën e tyre. Siç dihet, ligjërisht komunat janë të obliguara për të themeluar Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitetet si komitete të përhershme. Si mundësi për të ushtruar një fushë të caktuar të kompetencave komunale, Kuvendi i Komunës mund të themeloj komitete të tjera profesionale të cilat do të ndihmojnë punën e saj. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Kuvendi i Komunës duhet të themeloj komitete të tilla nëse e sheh të nevojshme dhe të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta. Për ta bërë këtë, Kuvendi i Komunës do të themeloj komitetet konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim marrjes.

Sa u përket komiteteve obligative, përveç Komitetit për Komunitete në Komunën e Kaçanikut, ato kanë qenë funksionale në të gjitha komunat e tjera. Sipas të dhënave në komuna janë mbajtur gjithsej 206 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe 161 mbledhje të Komitetit për Komunitete (KK). Në Komunën e Kaçanikut, KK nuk ka mbajtur asnjë mbledhje, ndërkaq ky komitet më pak funksional ka qenë në Komunat: Obiliq, Hani i Elezit, Rahovec dhe Mitrovicë. Në vijim është paraqitur figura me të dhënat e mbledhjeve të komiteteve të obligueshme nëpër komuna:




Fig.3. Të dhënat e mbledhjeve të kuvendeve të komunave për periudhën janar-qershor 2013

Ndërsa, varësisht nga specifikat e komunave, “Kuvendi i Komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisë të tyre”⁶. Gjatë kësaj periudhë mandatore është parë se një pjesë e madhe e komunave kanë themeluar komitete të tjera në fusha specifike si: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Arsimit dhe Kulturë; Zhvillim Ekonomik; Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë, në pak raste është vërejtur se këto komitete shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e komunave të cilat kanë themeluar komitete të tjera:




Fig.4. Të dhënat e për numrin e komunave të cilat kanë themeluar Komitete specifike në fusha të caktuara të kompetencave të tyre

⁶ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 51.2

Sipas të dhënave del që në komuna janë themeluar gjithsej 49 Komitete të veçanta për fushat e ndryshme të veprimtarisë së komunave. Për më saktë, *në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale*, tetë (8) komuna kanë themeluar Komitete të veçanta, siç janë: Peja, Prishtina, Deçani, Klina, Mitrovica, Obiliqi, Vushtrria, Gjilani dhe Malisheva. *Për çështje të arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit* janë themeluar Komitetet në 11 (njëmbëdhjetë) kuvende të komunave: Gjilan, Pejë, Lipjan, Istog, Prishtinë, Klinë, Malishevë, Gllogovc, Mitrovicë, Obiliq, Vushtri. *Në fushën e zhvillimit ekonomik*, janë themeluar komitete në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Gllogovc, Gjilan, Mitrovicë, Obiliq dhe Vushtri. *Planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit*, janë themeluar komitete në këto komuna: Gjilan, Prishtinë, Deçan, Lipjan, Mitrovicë, Obiliq dhe Vushtri. Për sferën e *shërbimeve publike*, Komitete të veçanta kanë themeluar kuvendet e komunave: Gjilan, Prishtinë, Pejë, Klinë, Shtime, Mitrovicë dhe Obiliq. *Për çështje pronësore, kadastër dhe banim*, Komitete të veçanta janë themeluar në kuvendet e komunave: Gjilan dhe Prishtinë. *Në fushën e të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe barazisë gjinore*, Komitete të veçanta janë themeluar në: Gjilan, Gllogovc, Mitrovicë, Obiliq, Vushtri, Prizren. Komitete të tjera specifike janë themeluar në Komunën e Malishevës siç është *Komiteti për Diasporë dhe Komiteti për familje të Dëshmorëve, Invalid të Luftës*, në Komunën e Fushë Kosovës është themeluar *Komiteti për Ndërmjetësim*, në Komunën e Prizrenit - *Komiteti për trashëgimi kulturore të qytetit të Prizrenit*, në Komunën e Lipjanit - *Komiteti për Bujqësi dhe Komiteti për çështje qytetare*.

Krahas të drejtës fakultative të komunave për të themeluar komitete të tjera, ato janë të obliguara të themelojnë komitete konsultative sektoriale. Për ta bërë këtë, “Kuvendi i Komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes”⁷. Nga kjo dispozitë ligjore kuptohet që komunat janë të obliguara për të themeluar këto komitete, por aktualisht edhe kjo përgjegjësi në pak komuna është përmbushur, edhe pse është e drejtë e obligueshme. Në anën tjetër, në disa komuna, edhe pse janë themeluar komitetet konsultative, ato nuk kanë qenë funksionale. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e komunave të cilat kanë themeluar komitetet konsultative:

⁷ Ligji Nr. 03/ L – 040: “Ligji Për Vetëqeverisje Lokale”, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, 2008, neni 73.1, fq. 23.

Komitetet Konsultative




Fig.5. Të dhënat e për numrin e komunave të cilat kanë themeluar Komitete Konsultative në fusha të caktuara të kompetencave të tyre

Siç vërejmë nga figura e mësipërme, në komuna janë themeluar gjithsej **23 komitete konsultative**. Më hollësisht, *në fushën e Urbanizmit, Pronës, Gjeodezisë, Kadastrit, Mbrojtje të Mjedisit*, Komitete Konsultative janë themeluar në pesë (5) komuna: Ferizaj, Istog, Mitrovicë, Vushtrri, Hani i Elezit. Për *Arsim, Kulturë, rini dhe sport*, komitete konsultative janë themeluar në 4 komuna: Hani i Elezit, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë, Ferizaj. Për çështje të *shërbimeve publike dhe emergjencës* janë themeluar komitete konsultative në 3 komuna: Hani i Elezit, Mitrovicë, Lipjan. Për *shëndetësi dhe mbrojtje sociale*, janë themeluar komitete konsultative në 3 komuna: Vushtrri, Mitrovicë dhe Ferizaj. Në *fushën e zhvillimit ekonomik*, janë themeluar komitete konsultative në 3 komuna: Ferizaj, Skenderaj, Vushtrri. Për *të drejtat e njeriut (barazi gjinore)*, janë themeluar komitete konsultative në 2 komuna: Vushtrri, Ferizaj. Për persona me aftësi të kufizuara është themeluar komiteti konsultativ në Komunën e Ferizajt e gjithashtu në këtë komunë është themeluar Komiteti për kategoritë e dala nga lufta.

8. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Në nivelin lokal, trupa me rëndësi për sigurinë publike të qytetarëve por edhe më gjerë janë Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Themelimi i KKSB-së bazën ligjore e ka me Ligjin për Policinë, ndërsa përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligimet tjera fillimisht janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009

MPB-02/2009 MAPL. Me ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, është definuar edhe më qartë pozicioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në raport me komunën. Edhe me këto ndryshime normative është përcaktuar roli preventiv i këtij Këshilli ndaj dukurive negative në shoqëri dhe janë përcaktuar një numër i objektivave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit. Për më tepër, me ndryshimet normative, çështja e sigurisë i lihet më tepër në kompetencë komunave, duke përcaktuar të drejtën e Kuvendit të Komunës në themelimin e KKSBS-së me vendim dhe përgjegjësinë e kryetarit të komunës për të bërë më funksionale këtë organ. Ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve që duhet mbajtur KKSBS gjatë një viti, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë⁸. Përkundër normimit të këtyre kriterëve bazë për funksionalizimin e KKSBS-ve, në institucionet e nivelit lokal të qeverisjes ende mungon vetëdija e përgjithshme për rëndësinë e këtij mekanizmi. Për këtë çështje, më së miri flasin të dhënat për numrin e takimeve të KKSBS-së gjatë kësaj periudhe, si vijon:




Fig.6. Të dhënat e takimeve të KKSBS-së në komuna gjatë periudhës janar-qershor 2013

Sipas të dhënave, këto këshilla në këtë periudhë kanë mbajtur gjithsej 71 takime. Është Komuna e Hanit të Elezit ajo e cila ka mbajtur numrin më të madh të mbledhjeve të këtij Këshilli, me gjithsej 5 takime. Pastaj janë 12 komuna të tjera të cilat kanë mbajtur nga 3 mbledhje, duke përmbushur normën e paraparë ligjore për mbajtje të takimeve, kurse 12 komuna të tjera kanë mbajtur nga 2 takime. Krahas tyre, komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim janë: Shtërpca, Skenderaj dhe Mamusha.

⁸ Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 11.2.

Përveç këtij aspekti, me ndryshimet normative të Udhëzimit Administrativ për KKSBB-të, u shtrua edhe çështja e rregullimit të KKSBB-ve në aspektin juridik në nivel lokal, përkatësisht nxjerrjes së Vendimeve nga Kuvendet e Komunave për themelimin të KKSBB-së sipas normave nënligjore të përcaktuara. Lidhur me këtë, themelimi i KKSBB-ve nga Kuvendet e Komunave është bërë pothuajse në të gjitha komunat. Në bazë të raporteve të monitorimit, në vitin 2013, mbesin vetëm komuna e Kaçanikut dhe Skenderajt për të nxjerrë vendimin për themelimin e KKSBB-ve sipas referencave të Udhëzimit Administrativ në fuqi.

9. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, Komunat kanë për obligim që në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tyre, dhe në bazë të nevojave të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në territorin e tyre të krijojnë struktura administrative adekuate, përkatësisht Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, qëllimi i të cilave shprehet për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve. Sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, ZKK duhet të jetë pjesë integrale e administratës komunale. Po ashtu, ajo duhet të njihet Statutin e Komunës, i cili është akti më i lartë normativ në komunë dhe që miratohet dhe ndryshohet nga Kuvendi i Komunës. Siç dihet, me Statutin e Komunës përcaktohet struktura organizative e komunës dhe merren parasysh të gjitha komunitetet e saj, diversiteti kulturor, interesat ekonomike dhe gjuhësore si dhe struktura shoqërore e popullatës, përfshirë prioritetet e tyre të veçanta dhe resurset komunale. Prandaj, mbi bazën e kësaj, Rregullorja e Qeverisë ka normuar që këto zyre të jenë pjesë integrale e administratës komunale, në mënyrë që të krijohen mekanizma të fuqishëm administrativ të nivelit lokal për ofrimin e shërbimeve të posaçme për komunitete.

Në të vërtetë, me funksionalizimin e ZKK-ve, duke përfshirë edhe strukturat e nivelit përfaqësues (përkatësisht mekanizmave të Kuvendit e Komunës) siç janë: komiteti për komunitete, zv.kryesuesi për komunitete dhe nënkryetari i komunës për komunitete, përmbyllin kornizën e mekanizmave të brendshëm komunal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

MAPL, bazuar në mandatin e saj, ka shqyrtuar ligjshmërinë e të gjitha Statuteve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe në këtë segment ka vërejtur se, jo të gjitha Komunat kanë rregulluar aspektin juridik të këtyre Zyrave, me aktin më të lartë normativ komunal, përkatësisht Statutin e Komunës.

Sipas raportit, del që në disa komuna ende nuk është bërë harmonizimi Statuteve të komunave me Rregulloren Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe

Kthim. Kësisoj, mënyra e organizimit dhe të njohjes së këtyre zyrave me Statutin e komunës qëndron si në vijim:

Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim




Fig.7. Mënyra e rregullimit juridik të ZKK-vë në nivelin lokal dhe funksionimi i tyre.

Në Komunitat: Gjakovë, Deçan, Rahovec, Istog, Pejë, Klinë, Ferizaj, Mamushë, Fushë Kosovë, Lipjan, Drenas, Gjilan, Prishtinë, Kamenicë, Novobërdë, Mitrovicë dhe Skenderaj, këto zyra janë përfshirë në Statutin e Komunës. Kurse, në komunat: Malishevë, Suharekë, Kaçanik, Shtime, Vitia, Hani i Elezit, Podujeva, Obiliq, Dragash, Vushtrri, Prizren, Ranillug, Graçanicë, Shtërpçë, Klokot, Partesh, këto zyra janë funksionale por nuk njihen me Statutin e Komunës. Për dallim nga komunat e tjera, në Komunën e Junikut, kjo zyre, përveç që nuk është përfshirë kjo zyrë në Statutin e Komunës, ajo nuk është e themeluar fare. Edhe pse të njohura me Statutin e komunës, në disa komuna ende ekzistojnë disa të meta në këtë drejtim siç është:

- Emërtimi i ZKK-së nuk është në përputhje me Rregulloren e Qeverisë (Gjakovë, Klinë, Lipjan, Dragash).

- Në Komunën e Deçanit nuk janë paraparë të gjitha pozitat në kuadër të ZKK-së sipas Rregullores së lartpërmendur.
- Sa i përket formës së raportimit, edhe në Statutin e Komunës së Pejës dhe asaj të Klinës është paraparë që Zyra t'i raportoj Komitetit për Komunitete dhe jo kryetarit të komunës, siç është e përcaktuar me rregulloren qeveritare..

10. Takimet publike me qytetarë

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale. Organizimi i takimeve publike me qytetarë varion nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë, derisa disa të tjera janë më të rezervuara në këtë drejtim. Për të ngritur një paralele në mes të komunave, përgjigjen e jep pasqyra e të dhënave si në vijim:



Fig.7. Të dhënat e takimeve publike me qytetarë në komuna gjatë periudhës janar-qershor 2013

Sipas figurës së mësipërme vërejmë se 16 komuna kanë organizuar nga një (1) takim publik me qytetarë, 9 komuna kanë mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë, 3 takime ka mbajtur një komunë, 2 komuna nga 4 takime, një komunë 5 takime, ndërsa 5 komuna nuk kanë mbajtur asnjë takim. Komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim janë: Istogu, Fushë-Kosova, Graçanica dhe Obiliqi.

Megjithatë tek komunat të cilat dominojnë me numrin më të madh të takimeve, ka ndikuar organizimi i takimeve shitesë (jashtë atyre të obligueshme sipas nenit 68.1 të LVL-së) të cilat janë organizuar në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit, qytetarëve u ka mundësuar ofrimin e vërejtjeve, propozimeve, vlerave dhe kërkesave të tyre në raport me nevojat. Prandaj, këto takime

praktikisht paraqesin vlera të demokracisë së drejtpërdrejtë, përkundër demokracisë së tërthortë ku kërkesat e qytetarëve realizohen përmes të zgjedhurve të tyre apo programeve të caktuara. Prandaj, aplikimi i kësaj forme të konsultës së përgjithshme, duhet të vazhdoj edhe në të ardhmen dhe të jetë pjesë integrale e politikave komunale.

11. Ueb-faqet zyrtare të komunave

Një nga përgjegjësitë dhe sfidat kryesore të komunave dhe institucioneve publike të Republikës së Kosovës është funksionalizimi i ueb-faqeve të internetit. Marrë parasysh që komunat kanë aktivitete të ndryshme brenda për brenda institucioneve komunale dhe jashtë saj, është paraparë që futja e të dhënave në ueb faqet komunale të jetë e domosdoshme, ngase ju mundëson qytetarëve të jenë më të informuar lidhur me rrethanat dhe gjendjen aktuale të komunës. Ueb faqja zyrtare e komunave është faqe multilinguale dhe përmbajtjet duhet të lansohen në gjuhët zyrtare. Detyra për publikimin e akteve komunale është çështje e normuar me Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Pra, sipas kësaj Rregulloreje publikimi i të gjitha akteve nënligjore të komunës është i obligueshëm. Në vijim kemi paraqitur të dhënat rreth azhurnimit të ueb-faqeve të komunave:

Publikimi i akteve të kuvendeve të komunave në ueb-faqet zyrtare




Fig. 8. Numri i komunave të cilat kanë publikuar aktet e kuvendeve të komunave në ueb faqet zyrtare plotësisht, pjesërisht dhe ato të cilat nuk i kanë publikuar

Sipas figurës së mësipërme shihet që 10 komuna i kanë azhurnuar rregullisht ueb-faqet zyrtare me publikimin e akteve të kuvendeve, 11 prej tyre vetëm pjesërisht ndërsa 14 nuk i kanë publikuar fare. Komunitat të cilat publikimin e akteve të kuvendit e kanë bërë me rregull janë: Gjiçlani, Kaçaniku, Graçanica, Klllokoti, Shtimes, Lipjani, Malisheva, Mitrovica, Kamenica, Hani i Elezit. Komunitat të cilat këtë e kanë bërë pjesërisht, që do të thotë se nuk i kanë publikuar të gjitha aktet e miratuara janë: Peja, Ferizaj, Deçani, Shtërpca, Prizreni, Podujeva, Glllogovci, Obiliqi, Vitia, Vushtrria, Hani i Elezit dhe Dragashi. Krahast tyre, komunitat të cilat nuk i kanë publikuar asnjë nga aktet e miratuara në Kuvendet e Komunave janë: Kllina, Parteshi, Ranillugu, Prishtina, Istogu, Skenderaj, Fushë-Kosova, Gjakova, Novobërda, Rahoveci, Suhareka, Mamusha dhe Juniku.

Për çështje të transparencës e rëndësishme është edhe qasja në aktet të cilat miratohen nga kryetari i komunës. Vetëm dy komuna e kanë rregulluar aplikacionin e akteve të miratuara nga kryetari i komunës në ueb-faqet komunale, ndërsa vetëm dy prej tyre i kanë publikuar vendimet e kryetarit (Ferizaj dhe Kaçaniku). Tridhjetë e dy (32) komuna të tjera, nuk i kanë publikuar asnjë nga aktet e miratuara të kryetarit të komunës.

Siç vërejmë, gjatë periudhës janar-qershor 2013, plasimi i informacioneve ka qenë jo koherent. Nga të dhënat e prezantuara më sipër del që pjesa më e madhe e komunave nuk i kanë azhurnuar me rregull ueb-faqet komunale me dokumentet zyrtare, siç janë, Rregulloret, Vendimet, Planet, Raportet e ndryshme etj. Përveç aspektit të transparencës, publikimi i akteve në ueb faqet zyrtare lidhet edhe me hyrjen në fuqi të të një akti nënligjor komunal. “Aktet nënligjore të komunës hyjnë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës”⁹. Prandaj në këtë segment shihet se ka pasur ngecje duke marrë parasysh edhe faktin se çështja e sistemimit të të dhënave nëpër ueb-faqet komunale nuk është unike. Sistemimi i akteve duhet bërë sipas organit që i ka nxjerrë, ndërsa në ueb-faqet e komunave është parë se aktet e miratuara në të shumën e rasteve janë publikuar nëpër aplikacione të ndryshme dhe vështirë për t’u identifikuar. Po ashtu, në disa komuna sistemimi i akteve të publikuara nuk është bërë sipas llojit të tyre, por është bërë në një dosje të përbashkët e cila ka përfshirë akte të ndryshme dhe të pa seleksionuara.

⁹ Rregullorja Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave, neni 18.1.

II. AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Vështrime hyrëse

Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës në Kosovë, ndër të tjera është miratimi dhe nxjerrja e vendimeve, rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Po ashtu kuvendi ka funksion edhe “të miratojë statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, merr vendime si dhe nxjerr rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët (e komuniteteve), si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Në këtë pjesë të raportit kemi paraqitur numrin e përgjithshëm të akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave, llojet e tyre, çështje procedurale që lidhen me miratimin e akteve, dërgimin e tyre për vlerësim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës, kualitetin e akteve komunale, ligjshmërinë e tyre, shkeljet ligjore, nevojën për evitimin e jo-ligjshmërisë, miratimin e kërkesave të organit mbikëqyrës për rishqyrtim të akteve të kundërligjshme të vlerësuara nga MAPL por edhe Komisionet ndër-sektoriale.

1. Rregulloret dhe vendimet e miratuara në Kuvendet e Komunave

Edhe në periudhën janar-qershor 2013 Komunitat kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Aktet e nxjerra gjatë kësaj periudhë rregullojnë fushave të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret mund të përmendim: miratimin e planeve rregulluese urbane, akteve nga fusha e mjedisit, vendimeve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme, vendimeve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike, akteve të karakterit financiar siç janë Rregulloret për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, rishikimin buxhetor, akte të cilat promovojnë zhvillimin ekonomik të Komunave etj. Nga aspekti numerik, gjatë kësaj periudhë janë miratuar 740 Vendime dhe 98 Rregullore. Në vijim është paraqitur figura me të dhënat krahasuese të akteve të miratuara në kuvendet e komunave:




Fig. 9. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave, janar qershor 2013




Fig. 10. Numri i Rregulloreve të miratuara në Kuvendet e Komunave, janar-qershor 2013

Pasqyra e të dhënave numerike për aktet e miratuara gjatë kësaj periudhe tregon se numrin më të madh të Rregulloreve e ka miratuar Komuna e Mitrovicës me 15 të miratuara, pastaj Komuna e Rahovecit dhe Klokotit me 7 Rregullore të miratuara, Komuna e Vushtrrisë, Ranillugut dhe Fushë Kosovës me 5 Rregullore, Komuna e Prishtinës, Gjilanit dhe Shtërpçës nga 4 Rregullore, Komuna e Deçanit, Istogut, Prizrenit, Shtimes, Hanit të Elezit, Kamenicës, Pejës dhe Lipjanit nga 3 Rregullore, Komuna e Junikut, Farizajt, Kaçanikut, Dragashit, Graçanicës dhe Novobërdës nga 2 Rregullore, Komuna e Gjakovës, Drenasit, Suharekës, Malishevës, Mamushës, Vitisë nga 1 Rregullore, kurse Komunitat: Obiliq, Partesh, Klinës, Podujevë dhe Skenderaj nuk kanë miratuar asnjë Rregullore.



Fig. 11. Numri i Vendimeve të miratuara në Kuvendet e Komunave, janar-qershor 2013

Sa u përket vendimeve, numrin më të madh e ka miratuar Komuna e Graçanicës me 48 vendime; pastaj Komunitat: Gjilan, Mitrovicë, Vushtri, Prizren dhe Kamenicë me nga 34 vendime të miratuara; Komuna e Novobërdës (28 Vendime); Komuna e Drenasit (26 vendime); Komuna e Gjakovës dhe Fushë-Kosovës (nga 25 vendime); Podujeva dhe Peja (nga 23 vendime); Komuna e Rahovecit, Suharekës dhe Prishtinës (nga 22 vendime); Klokoti dhe Shtërpça (nga 21 vendime), Ferizaj dhe Hani i Elezit nga (20

vendime): Shtime, Viti dhe Ranillug (nga 19 vendime); Skenderaji (18 vendime); Malisheva (17 vendime), Dragashi (16 vendime), Parteshi, Obiliqi dhe Lipjani (15 vendime); Deçani (14 vendime); Juniku, Kaçaniku dhe Klina (13 vendime); Istogu (12 vendime); Mamusha (6 vendime).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2012, në vitin 2013 komunat kanë shënuar rritje në miratimin e akteve komunale. Derisa në vitin 2012 kuvendet e Komunave kanë miratuar 617 vendime dhe 52 rregullore, epërsia numerike këtë vit është 123 vendime më tepër dhe 46 rregullore.

2. Llojet e akteve të miratuara

Sa u përket natyrës së akteve juridike nënligjore të komunave, në këtë periudhë janë miratuar akte të ndryshme në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tyre. Në këtë periudhë janë miratuar kryesisht Rregulloret për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2013, pastaj Rregulloret për taksa, tarifa dhe ngarkesa, Rregulloret për punën e Kuvendeve të Komunave, Rregullore për barazi gjinore (Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Viti, Kllokot), Rregullore për subvencione, Rregullore për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë negative, Rregullore për shërbimet publike dhe transportin publik etj.

Në disa komuna është nxjerrë Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, edhe pse një gjë e tillë nuk kërkohet me Ligjin nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Komunat të cilat e kanë miratuar këtë rregullore janë: Mitrovica, Kllokoti, Deçani dhe Kamenica. Rregullimi më i hollësishëm i procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim është parë si e nevojshme nga komunat për të rregulluar më afër procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Në komuna është vërejtur mungesa e qartësisë së dispozitave për disa raste më specifike të cilat ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale nuk i ka përfshirë, siç është çështja e dhënies së pronës në shfrytëzim për banim social, për zgjidhjen e banimit për personat e riatdhesuar, pastaj nuk është definuar edhe çështja e shqyrtimit të ankesave.

Lidhur me menaxhimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e saj, komunat kanë nxjerrë një numër të vendimeve për këtë qëllim. Gjatë kësaj periudhë janë nxjerrë 44 vendime për dhënien në shfrytëzim të

pronës së paluajtshme komunale, ndërsa 13 raste të këmbimit të pronës komunale me personat fizik dhe juridik. Në vijim kemi paraqitur skemën grafike me të dhënat për secilën komunë për rastet e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim dhe këmbimin:



Fig. 12. Numri i Vendimeve për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim gjatë periudhës janar-qershor 2013



Fig. 13. Numri i Vendimeve për këmbimin e paluajtshme komunale me personat fizik dhe juridik gjatë periudhës janar-qershor 2013.

Siç shohim nga figurat e mësipërme, komunat më tepër janë përqendruar në dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, se sa këmbimin e saj. Në këtë segment, ato kanë themeluar edhe komisionet përkatëse të cilat kërkohen me ligj, për të zhvilluar procedurat si dhe përzgjedhur ofertuesit më të përshtatshëm. Praktika e themelimit të këtyre komisioneve nuk ka qenë e njëjtë nëpër komuna, pasi që disa prej komunave kanë themeluar komisione të veçanta për secilin rast, ndërsa disa të tjera kanë themeluar komisione afatgjata për zhvillimin e këtyre procedurave. Megjithatë, më tepër është praktikuar mundësia e themelimit të komisioneve për raste të veçanta.

3. Aktet e miratuara të natyrës financiare

Përveç pronës së paluajshme, në komuna janë nxjerrë edhe shumë vendime të tjera. Ndër aktet të cilat gjenerojnë të hyra materiale për komunat kanë miratuar edhe Rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa. Zakonisht, plotësim-ndryshimet e kësaj rregulloreje bëhen para miratimit të buxhetit për të realizuar planifikimet buxhetore për vitin pasues, mirëpo gjatë kësaj periudhe pjesa më e madhe e komunave e kanë bërë rishqyrtimin e kësaj rregullore për shkak të kërkesës së Komisionit sektorial për harmonizimin e dispozitave të caktuara të rregullores me ligjet në fuqi.

Përveç kësaj, shumica e komunave e kanë realizuar edhe rishikimin e buxhetit për vitin 2013 (me përjashtim të komunës së Deçanit, Suharekës, Malishevë dhe Dragashit). Po ashtu, në shumicën e komunave është miratuar edhe Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2014-2016.

Komunat, me Rregullore të veçantë kanë përcaktuar kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve për kategoritë e ndryshme të personave fizik dhe juridik. Në këtë periudhë disa komuna kanë miratuar Rregulloren për ndarje të Subvencioneve, e të cilat janë: Suhareka, Rahoveci, Vushtrria, Ferizaji, Fushë-Kosova. Miratimi i këtyre rregullave nga Kuvendet e Komunave, mundëson një kontroll më të madh të shpenzimit të parasë publike nga kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale.

III. MBIKËQYRJA E KOMUNAVE NGA AUTORITETET QENDRORE

Vështrime hyrëse

Mekanizmi kryesor i qeverisë për ushtrimin e mbikëqyrjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është e drejta e autoritetit mbikëqyrës për shqyrtim administrativ të ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të komunave. Parimisht, MAPL-ja është autoriteti mbikëqyrës, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e komunave nuk i është dhënë me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato¹⁰. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, janë themeluar komisionet ndërministrore, sipas fushave specifike. Në këtë kapitull janë paraqitur rastet e shkeljeve ligjore, shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre nga MAPL, shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Komisionet ndërministrore, kërkesat për rishqyrtimin e akteve dhe veprimet e komunave pas pranimit të këtyre kërkesave. Gjithashtu, një pjesë e veçantë e raportit i është kushtuar rasteve të shkeljeve ligjore, ku janë elaboruar veç e veç të gjitha shkeljet ligjore në komuna.

1. Dërgimi i akteve për shqyrtim të ligjshmërisë

Duke marrë parasysh se MAPL është autoritet mbikëqyrës i komunave, komunat kanë përgjegjësi që sipas nenit 80 të LVL-së të dërgojnë aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Derisa në një periudhë komunat kanë paraqitur pengesa në dërgimin e akteve dhe nuk ka pasur një koordinim të mirë mes tyre dhe nivelit qendror, tani shumica e Komunave kanë rregulluar këtë aspekt. Në periudhën janar-qershor 2013, të gjitha komunat kanë sjellë aktet për vlerësim të ligjshmërisë, mirëpo disa prej tyre nuk kanë respektuar afatet ligjore për dërgim. Komunat të cilat janë vonuar në dërgimin e akteve janë: Rahoveci, Juniku, Deçani, Peja, Glllogoci, Mamusha dhe Prizreni. Problemet e vonësive kanë qenë të ndryshme, pasi që disa komuna aktet i kanë dërguar në formë fizike, disa të tjera kanë vonuar hartimin e tyre, ose nuk i kanë dërguar të gjitha aktet e miratuara. Krahës tyre, komunat e tjera kanë ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për dërgimin e akteve, të cilat i dërgojnë në formë elektronike dhe me të gjitha elementet e domosdoshme për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit të ligjshmërisë.

¹⁰ RKS, Kuvendi, LVL, Kreu X, Nenet 75 dhe 76

2. Shkeljet ligjore të evidentuara

Në bazë të mandatit të saj, MAPL ka ndërtuar një sistem të avancuar të monitorimit, i mbështetur në dy mënyra kryesore: përmes monitorimit me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komuna dhe përmes monitorimit elektronik i cili bazohet sidomos në sistemin e teleprezencës. Përmes monitorimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të kuvendeve të komunave, janë evidentuar të gjitha aktet e nxjerra në Kuvendet e Komunave. Aktet të cilat kanë nuk kanë qenë në kompetencë të autoriteteve të tjera të nivelit qendror, MAPL i ka vlerësuar nga këndvështrimi ligjor. Në anën tjetër, aktet e tjera i ka dërguar tek ministritë kompetente, përkatësisht në komisionet ndërmministrorë për të shqyrtuar ligjshmërinë e tyre. Nga i gjitha ky proces, ka dalë që të evidentohen një numër i shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve nga kuvendet e komunave. Në vijim, është paraqitur figura me të dhënat për procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale:




Fig. 14. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve komunale nga organi mbikëqyrës

Nga figura e mësipërme, shihet që nga 838 akte të miratuara në kuvendet e komunave janë evidentuar 51 akte të kundërligjshme. Prej tyre, MAPL ka vlerësuar 25 akte të kundërligjshme, ndërsa komisionet ndërmministrorë 26 akte.

3. Kërkesat e organit mbikëqyrës për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme nga komunat

Për të gjitha raste e shkeljeve ligjore të evidentuara, është bërë shkresë në komuna për rishqyrtimin e akteve dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin në fuqi. Nga komunat janë rishqyrtuar 41 akte, prej të cilave 16 janë harmonizuar me vërejtjet e organit mbikëqyrës, 25 vendime edhe pas rishqyrtimit nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesat e organit mbikëqyrës, ndërsa 10 akte nuk janë rishqyrtuar fare. Në kuadër të këtyre shifrave janë përfshirë edhe rastet të cilat janë kanë qenë pjesë e procedurës së shqyrtimit dhe rishqyrtimit për dy ose më tepër herë, e sidomos Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa. Më poshtë, në formë grafike janë paraqitur rastet e harmonizimit të akteve sipas rekomandimit të organit mbikëqyrës dhe rastet kur komunat kanë qëndruar prapa vendimit të mëparshëm të tyre:

Veprimet e Komunave ndaj kërkesave të organit mbikëqyrës




Fig. 15. Veprimet e komunave ndaj kërkesave të organit mbikëqyrës për rishqyrtimin e akteve

Për rastet të cilat nuk janë harmonizuar sipas rekomandimeve të organit mbikëqyrës, MAPL ka realizuar takime të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e komunave. Këto takime kanë treguar sukses në praktikë, pas ritheksimit të së drejtës së organit mbikëqyrës për kundërshtimit të aktit në gjykatën kompetente. Një pjesë e komunave kanë marrë parasysh pasojat e mosharmonizimit të akteve të kundërligjshme, e sidomos akteve të cilat i janë referuar dhënies së pronës komunale në shfrytëzim. Komunat të cilat i kanë rishqyrtuar

Sipas nenit 82.4 të LVL-së, “nëse komuna nuk përgjigjet brenda afatit apo refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtojë aktin në fjalë në Gjykatën e Qarkut që është kompetent për territorin e komunës, brenda 30 ditësh pas dështimit për t’iu përgjigjur njoftimit për refuzimin apo mbështetjen e vendimit apo aktit të kontestuar”.

aktet e kundërligjshme pas këtyre takimeve janë: Rahoveci, Prizren, Ferizaj, Kamenicë, Viti, Skenderaj dhe Gjakovë. Dispozita e përmendur e LVL-së për kundërshtimin e aktit të komunës në gjykatë nuk është treguar adekuate, pasi që kjo dispozitë nuk lejon asnjë masë për pezullimin e ekzekutimit të aktit deri në vlerësimin përfundimtar të Gjykatës. Kjo e drejtë i takon vetëm gjykatës, mirëpo deri në dërgimin e rasteve në gjykata, efektet negative të akteve mund të jenë të pariparueshme.

4. Llojet e shkeljeve ligjore

Aktet e kuvendeve të komunave të cilat janë vlerësuar të kundërligjshme gjatë kësaj periudhe janë të ndryshme. Shkelje ligjore janë paraqitur si në miratimin e vendimeve ashtu edhe të Rregulloreve. Po ashtu, ka pasur shkelje të natyrës procedurale. Në vijim, është paraqitur figura me llojet e shkeljeve dhe numrin e rasteve për komunat të cilat kanë nxjerrë akte të kundërligjshme:




Fig. 15. Numri dhe llojet e shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore nga kuvendet e komunave

Siç vërejmë, numri më i madh i shkeljeve gjatë kësaj periudhe kanë të bëjnë me Rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe Gjoba komunale. Gjithashtu, komunat kanë bërë shkelje të nenit 12 të Rregullores për hartimin e akteve komunale, i cili parasheh që amandamentimi, plotësimi ose shfuqizimi i një akti nënligjor të komunës bëhet nga akti i njëjtë nënligjor. Një numër i shkeljeve i referohen edhe dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim në kundërshtim me dispozitat ligjore, e gjithashtu edhe këmbimit të pronës së paluajtshme. Nga figura e mësipërme shohim se:

Shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale kanë bërë 8 komuna: Malisheva, Rahoveci, Shtime, Vushtrria, Istogu, Prishtina, Peja dhe Fushë Kosova.

Shkelje ligjore me rastin e ndërrimit të tokës, sipas komisionit ndërministror ka bërë Komuna e Gjakovës.

Ndryshimin e Rregulloreve me Vendime e kanë bërë këto komuna: Ferizaj, Klllokoti, Prishtina, Gjlani, Peja, Novobërda, Shtime, Gjakova, Kamenica dhe Ranillugu.

Shkelje me rastin e dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kanë bërë komunat: Rahovec, Ferizaj, Viti dhe Prizren.

Shkelje ligjore me rastin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale kanë bërë Komunat: Rahovec, Pejë, Prizren, Skenderaj dhe Graçanicë.

Shkelje procedurale me rastin e themelimit të Komisionit për zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale ka bërë komuna e Rahovecit.

5. Rastet e shkeljeve ligjore në komuna të konstatuara nga MAPL dhe veprimet e komunave ndaj shkresave për rishqyrtim të akteve

Në vijim, janë elaboruar shkeljet ligjore të kuvendeve të komunave me rastin e nxjerrës së akteve nënligjore të cilat janë vlerësuar nga MAPL dhe nga e cila është kërkuar rishqyrtimi i tyre:

Rahovec

1) Në Komunën e Rahovecit, një numër i rasteve të shkeljeve ligjore kanë mbetur si të tilla nga viti i kaluar dhe nuk janë rishqyrtuar sipas rekomandimeve të institucionit mbikëqyrës. Mirëpo, prej rasteve të cilat janë bartur nga viti 2012 në këtë periudhë, Komuna e Rahovecit ka rishqyrtuar dhe shfuqizuar vetëm dy vendime që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, njëri për tregjet dhënë shoqatave të luftës si dhe tjetri për deponinë e mbeturinave të ngurta po ashtu dhënë shoqatave të luftës.

Prizren

1) Vendimi Nr. 01/011-13245 për dhënien në shfrytëzim ngastrën kadastrale Nr. 1194 në vendin e quajtur Koqiqev për ndërtimin e kompleksit afarist banesor në lagjen “Jeni Mahalla”.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka dërguar komunës së Prizrenit shkresën me datën 07.02.2013, me të cilën shkresë konstaton se ka shkelje dhe në përputhje me këtë shkresë komuna e Prizrenit të rishqyrtoj vendimin dhe në përputhje me shkresën për rishqyrtim të kërkesës të harmonizoj aktin. Kuvendi i Komunës së

Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me 21.02.2013, ka harmonizuar aktin e vlerësuar kundërligjshëm në përputhje me shkresën për rishqyrtimin e aktit.

Ferizaj

1) **Vendimi për dhënie në shfrytëzim të banesave me afat të pa përcaktuar për familjet e dëshmove të UCK-së, i cili vendim është në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.**

Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal, më datën 24.04.2013, i ka dërguar shkresën komunës së Ferizajt, për të rishqyrtuar vendimin dhe të harmonizoj ketë akt në përputhje me nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa me datën 29.05.2013, Kuvendi i Ferizajt ka ndërmarrë veprimin dhe ka rishqyrtuar aktin në përputhje me shkresën e MAPL-së.

2) **Vendimi 01. Nr. 26 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale**

Kuvendi i Komunës së Ferizajt me datën 11.04.2013 ka miratuar vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij vendimi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datën 02.05.2013, i ka dërguar shkresën Komunës së Ferizajt, me të cilën kërkon nga Kuvendi i Komunës rishqyrtimin e këtij vendimi dhe harmonizimin e tij me Ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Kuvendi i Komunës së Ferizajt, me datën 29.05.2013, ka ndërmarrë veprimin dhe ka rishqyrtuar aktin në përputhje me shkresën e organit mbikëqyrës.

Viti

1) Kuvendi i Komunës së Vitisë, me datën 14.03.2013 ka miratuar Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë në pronësi shoqërore, në shfrytëzimin të përkohshëm Bashkësisë Islame. Organi mbikëqyrës ka vlerësuar të kundërligjshëm këtë akt dhe me datën 24.04.2013 i ka dërguar shkresë Komunën e Vitisë për të rishqyrtuar aktin në fjalë. Kuvendi i Komunës së Vitisë, me datën 14.05.2013, e ka rishqyrtuar aktin dhe në përputhje me shkresën e MAPL-së duke e harmonizuar këtë vendim me kërkesën e organit mbikëqyrës.

Kamenicë

1) Kuvendi i Komunës së Kamenicës me datën 26.02.2013 ka miratuar **Vendimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**. Ky vendim është vlerësuar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB-032012 MAPL. Me datën 10.04.2013, MAPL ka dërguar shkresë në Komunën e Kamenicës për të rishqyrtuar këtë

vendim. Me këtë rast, Kuvendi i Komunës së Kamenicës me datën 29.03.2013 ka ndermarrë veprimin për rishqyrtimin e këtij vendimi duke e harmonizuar në përputhje me kërkesën e MAPL-se.

Skenderaj

1) Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e mbajtur me datën 18.03.2013 ka miratuar Vendimin Nr. 01/464-67 për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e rrugës. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL, me datën 29.04.2013, i është dërguar shkresa Komunës së Skenderajt, me të cilën kërkohet të respektohet Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Pas marrjes së shkresës, Komuna e Skenderajt, me datën 29.04.2013 ka rishqyrtuar vendimin duke e harmonizuar me kërkesën e organit mbikëqyrës.

6. Komunat të cilat nuk kanë rishqyrtuar vendimet e kundërligjshme me kërkesat e organit mbikëqyrës për respektim të ligjshmërisë

Komuna e Prizrenit

1) Vendimi Nr. 01/011-13249 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në ngastrën kadastrale Nr. 70068/2 për ndërtimin e bllokut afarist urbanistik Zona 3.

Këtë vendim MAPL e ka vlerësuar të kundërligjshëm dhe me datën 07.02.2013 i ka dërguar shkresën Komunës së Prizrenit për rishqyrtim të aktit. Mirëpo, Kuvendi i Komunës së Prizrenit edhe pse në mbledhjen e mbajtur me 23 maj 2013 e ka pasur në rend dite rishqyrtimin e këtij akti, këtë nuk e ka bërë duke e shtyrë këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e radhës.

2) Vendimi Nr. 01/011-12258 për aprovimin e kërkesë së Komisionit për dhënien në shfrytëzim z. Shaban Shala ngastrën kadastrale Nr. 07326/2 dhe Nr. 07326/1 në lagjen "Dardania"

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datën 07.02.2013, ka dërguar shkresën për Komunën e Prizrenit me kërkesën për të rishqyrtuar aktin, mirëpo Komuna e Prizrenit nuk e ka zbatuar kërkesën e MAPL-së dhe nuk e ka rishqyrtuar vendimin në fjalë.

3) Vendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pronën e paluajtshme komunale Teqesë së Madhe - Tarikatit "Saadi"

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, këtë vendim e ka vlerësuar të kundërligjshëm. Me datën 12.06.2013, MAPL ka dërguar shkresën për rishqyrtim të

aktit në Komunën e Prizrenit. Me datën 04.07.2013 Kuvendi i Komunës ka bërë rishqyrtimin e këtij vendimi si dhe ka harmonizuar konform kërkesës së MAPL-së.

Pejë

1)Vendim Nr. 463-597 për këmbimin e pronës së paluajtshme publike me pronën private të Bakir Burinit me qëllim realizimit të projektit të shëtitores pranë “Lumëbardhit”.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, këtë vendim e ka vlerësuar të kundërligjshëm dhe me datën 24.04.2013, ka dërguar shkresën në komunë për rishqyrtimin e këtij vendimi dhe harmonizimin me Ligjin për dhënie në shfrytëzim të këmbim të pronës komunale. Kuvendi i Komunës së Pejës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të rishqyrtuar dhe harmonizuar këtë vendim.

2)Vendim Nr. 463-975 lidhur me propozimin për këmbim të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të Enver Musaj me qëllim ndërtimin e objektit të prokurorisë komunale.

MAPL, këtë vendim e ka vlerësuar të kundërligjshëm. Me datën 24.04.2013, MAPL ka dërguar shkresën për rishqyrtimin e këtij vendimi në Komunën e Pejës. Kjo e fundit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta harmonizuar këtë vendim sipas kërkesës së MAPL-së.

3)Vendim për miratimin e propozimit për këmbim pronash në mes komunës dhe Agron Morinës me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e fushave sportive për sportistët e klubit K.F “Besa”.

Këtë vendim, MAPL e ka vlerësuar të kundërligjshëm dhe me datën 24.04.2013 ka dërguar kërkesën për rishqyrtimin e këtij akti. Lidhur me këtë rast, Komuna e Pejës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të rishqyrtuar vendimin e kontestuar.

Obiliq

1)Në mbledhjen e parë të mbajtur më 25.01.2013, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka diskutuar për projektin e ngrohjes së qytetit nga TC „Kosova B”. Anëtarët e kuvendit gjatë diskutimit të tyre shtruan nevojën se me ndryshimin e trasesë së ngrohjes, duhet të përfitoj edhe Komuna e Obiliqit, meqenëse traseja kalon nëpër territorin e Komunës së Obiliqit. Kjo ishte një çështje mjaft kontestuese, mirëpo në mënyrë unanime u miratua Vendimi me të cilin obligohet ekzekutivi i komunës që të bashkëpunoj me institucionet e projektit të ngrohjes së qytetit i cili do të kyçet nga termocentrali “Kosova B”, me kusht që të mos lëshohet leje pune për këtë projekt, derisa të arrihet marrëveshja nga të dy palët dhe institucionet që financojnë këtë projekt. Me këtë vendim po ashtu është

kërkuar që gjithsesi në projekt të përfshihet edhe qyteti i Obiliqit si shpërblim për të gjitha dëmet që i shkaktohen kësaj Komune.

Për këtë rast, MAPL është drejtuar me shkresë me të cilën Vendimi i lartpërmendur është cilësuar i kundërligjshëm dhe është kërkuar që Komuna të rishqyrtoj këtë vendim, me arsyetimin se Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Siç dihet Kuvendi i Komunës nuk ka kompetencë ligjore, për të obliguar administratën komunale, përkatësisht Drejtorin e Komunale për Pronë, Urbanizëm, Kadastër dhe Planifikim për mos lëshimin e lejeve të punës, në rast se plotësohen kushtet ligjore sipas procedurës administrative. Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur në muajin më 28.05.2013, kuvendi e ka rishqyrtuar vendimin por më shumicë të votave prapë e ka lenë në fuqi vendimin e mëparshëm pra nuk e ka harmonizuar në përputhje me kërkesën e MAPL-së, për rishqyrtimin e këtij vendimi.

Novobërdë

1) Kuvendi i Komunës së Novobërdës me datë 20.05.2013 ka miratuar Vendimin nr. 02/511 për dhënien në shfrytëzim të zyrës për nevoja të Bankës për Biznes. MAPL, ka vlerësuar ligjshmërinë e këtij vendimi dhe me datën 19.06.2013 i ka dërguar shkresë Komunës së Novobërdës për të rishqyrtuar këtë vendim. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta harmonizuar këtë akt sipas kërkesës së MAPL-së.

Viti

1) Me datën 17.04.2013 Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar Vendimin për themelimin e ndërmarrjes publike komunale. Me datën 02.05.2013, MAPL ka dërguar shkresë Komunës së Vitisë për të rishqyrtuar këtë vendim dhe për të vepruar sipas dispozitave të Ligjit për ndërmarrjet publike. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për rishqyrtimin e vendimit në fjalë.

Ranillug

1) Kuvendi i Komunës së Ranillugut me datën 22.02.2013 ka miratuar Vendimin për plotësim ndryshimin e Rregullores së Punën se Kuvendit të Komunës. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL, është konstatuar se Kuvendi nuk ka miratuar këtë vendim në përputhje me Rregulloren Nr. 01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave. Me datën 22.02.2013, Komunës së Ranillugut i është dërguar shkresa për rishqyrtimin e aktit në fjalë. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim.

2) Kuvendi i Komunës së Ranillugut me datën 22.02.2013, ka miratuar Vendim për plotësim e Rregullores mbi Transparencën. Edhe ky vendim është vlerësuar i

kundërligjshëm, mirëpo komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të harmonizuar sipas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL.

Graçanicë

1) Kuvendi i Komunës së Graçanicës me datën 04.04.2013 ka nxjerrë Udhëzim për ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës. Pas shqyrtimit të ligjshmerisë, MAPL, me datën 25.04.2013 ka dërguar shkresën për rishqyrtimin e këtij akti. Kuvendi i Komunës së Graçanicës ende nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

2) Kuvendi i Komunës së Graçanicës, me datën 04.04.2013 ka miratuar Vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronën private të Milora (Svetislav) Kostić dhe Ivan (Svetislav) Kostić. Për këtë vendim, MAPL ka konstatuar joligjshmërinë duke kërkuar që akti në fjalë të rishqyrtohet. Komuna e Graçanicës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta harmonizuar këtë akt në përputhje me kërkesën e MAPL-së të dërguar me datë 24.05.2013 për rishqyrtimin e këtij vendimi.

7. Rastet e shkeljeve procedurale

Rahovec

2) Në periudhën janar-qershor 2013, MAPL ka konstatuar se procedurat e ndjekura me rastin e nxjerrjes së Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale nuk kanë qenë në harmoni me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Më konkretisht nuk është respektuar paragrafi 3 i nenit 8 të këtij ligji, sipas të cilit, “propozimi për anëtarët e Komisionit aprovohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit”. Me rastin e themelimit të këtij Komisioni, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar vetëm përbërjen e tre anëtarëve të propozuar nga Kuvendit i Komunës, ndërsa jo edhe përbërjen e Ekzekutivit të Komunës dhe shoqërisë civile, pasi që nuk ishin dhënë propozimet. Për këtë vendim, MAPL ka bërë shkresë me të cilën është kërkuar rishqyrtimi i këtij vendimi dhe miratimi i tërësishëm i përbërjes së Komisionit për vlerësim të ofertave në Kuvendin e Komunës, mirëpo Komuna e Rahovecit nuk ka marrë parasysh kërkesën për rishqyrtim të aktit. Komisioni ka vazhduar punën dhe ka përzgjedhur ofertuesin të cilit i është dhënë në shfrytëzim prona e paluajtshme komunale në afatin prej 15 vitesh.

Kaçanik

1) Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 11.02.2013, nuk ka respektuar Ligjin për vetëqeverisje lokale përkatësisht nenin 44.3 në të cilin shprehimisht thuhet se “pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut gjatë mbledhjes ka shtuar pikën për “Propozim-vendimin për lejimin e shumës prej 2149 euro për shënimin e 5 vjetorit të pavarësisë”.

Në lidhje me këtë rast, MAPL ka konstatuar se Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka bërë shkelje procedurale dhe me datën 22.02.2013 i është dërguar shkresë ligjore kësaj komune, me të cilën është kërkuar që kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut të respektoj dispozitat ligjore që mbledhjet e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës të jetë në harmoni me nenin 44.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Dragash

1) Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.01.2013 ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 44.3 të LVL. Sipas dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht nenit 44.3 “pikat e përcaktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes”.

Rekomandime:

1. Komunat të njoftojnë me kohë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
2. Të zbatojnë praktikën më të mira për shpërndarjen e informatave për mbledhjet e kuvendit të komunës, duke përdorur format më efikase për informimin e qytetarëve.
3. Komunat të vazhdojnë me dërgimin e akteve të Kuvendeve të Komunave në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë, konform nenit 80.1 të LVL-së.
4. Komunat të dërgojnë me rregull listën e akteve të nxjerra nga kryetari i komunës, sipas nenit 80.1 të LVL-së.
5. Të respektohen kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve në afatin e paraparë ligjor.
6. Aktet e kundërligjshme të trajtohen sipas afateve ligjore dhe të harmonizohen me kërkesat e organit mbikëqyrës.
7. Në rastet kur komunat kanë vështirësi në hartimin e akteve të përgjithshme, të praktikojnë konsultimin paraprak siç është përcaktuar me nenin 83 të LVL-së.
8. Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e miratimit të akteve juridike nënligjore, e në veçanti të respektohen procedurat ligjore për dhënien së pronës komunale në shfrytëzim.
9. Të gjitha aktet e miratuara në kuvendin e komunës si dhe aktet e kryetarit të komunës të publikohen në ueb-faqet zyrtare të komunave.
10. Të respektohen dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, që ka të bëjë me përkthimin e materialeve të mbledhjeve si dhe akteve të kuvendeve.
11. Kuvendet e komunave të harmonizojnë konstituimin e KKSB-së konform U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB. Po ashtu komunat duhet të mbajnë me rregull mbledhjet e KKSB-së.
12. Komuna e Kaçanikut dhe Skenderajt të nxjerrin vendimin për themelimin e KKSB-së sipas rregullave të reja të udhëzimit administrativ.
13. Të respektohen dispozitat ligjore lidhur me dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KKSB-ve në MAPL dhe MPB sipas U.A. të lartpërmendur.

Raporti i kompletuar është hartuar nga Diellor Gashi – Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave në mbikëqyrje të Xhevat Tafës - Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave si dhe Agron Maxhunit - Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave Lokale.

- Të dhënat janë mbledhur dhe analizuar nga ekipet monitoruese të Divizionit të Monitorimit të Komunave.

1. Andrijana Disic
2. Gzim Sahiti;
3. Hamit Fazliu
4. Kujtim Aliu
5. Manushaqe Muçaj
6. Ramadan Potera
7. Zajrete Sylejmani

- Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në pjesë raport janë përgjegjës zyrtarët e monitorimit të MAPL-së dhe zyrtarët e Komunave të Republikës së Kosovës;

- E Drejta autoriale e këtij raporti i takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;